



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## RAPORT VJETOR 2022

Oda e Mjekëve të Kosovës



Janar 2023

Prishtinë

**Përmbajtja:**

RAPORT VJETOR 2022 .....	1
1. Infrastruktura Juridike .....	3
2. Këshilli Drejtues .....	4
3. Anëtarësimi.....	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional .....	8
6. Licencimet.....	9
7. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të .....	9
8. Këshilli Mbikqyrës .....	9
9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së .....	9
10. Komisioni për Edukim Specialistik.....	10
11. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së.....	10
12. Raporti Financiar.....	10
12.1 Gjendja financiare – 31 dhjetor 2022 .....	10
12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional .....	11
12.3 Prokurimi.....	12
12.4 Botimi i Revistës Mjeku .....	13
12.5 Obelisk kushtuar punëtorëve shëndetësor.....	13
12.6 Tryeza e rumbullakët - “Gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë – Kemi apo nuk kemi sistem shëndetësor funksional? Kahja e reformës së nevojshme”.14	14
12.7 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim.....	14
12.8 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së.....	16
12.9 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike .....	17
12.10 Marrëdhënie ndërkombëtare .....	17
13. Plani i veprimit për 2023 .....	19
Projektet/Planet 2023 .....	19

## **1. Infrastruktura Juridike**

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2022 ka mbajtur katër (4) mbledhje të rregullta dhe në një rast u votua në mënyrë elektronike.

Me datë 17 janar 2022 u mbajt mbledhja e I-rë e legjislaturës së tretë e Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u zgjodhën:

- Nënkryetarët e OMK-së;
- Anëtarët e Këshillit Drejtues të OMK-së;
- Kryetari, zv.kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të OMK-së;
- Prokurori dhe zv.Prokurori i OMK-së.

Me datë 28 janar 2022 anëtarët përmes votimit elektornik me shumicë votash, votuan për plotësim-ndryshimin e Statutit të OMK-së, i cili edhe u aprovua nga Ministri Latifi

Me datë 16 shkurt 2022 u mbajt mbledhja e II-të (2) e legjislaturës së tretë e Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u zgjodhën:

- Kryetari, zv.kryetari dhe anëtarët e Gjyqit të Nderit të OMK-së.
- Anëtarët e Komisioneve të Përhershme të OMK-së.

Gjithashtu u marrën vendimet si në vijim:

- Vendim për caktimin e taksave administrative në OMK-së;
- Vendim për caktimin e kuotës së antarësisë në OMK-ë për vitin 2022;
- Vendim për miratimin e buxhetit të OMK-së për vitin 2022;
- Vendim për autorizimin e Këshillit Drejtues për negocijimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëfinancim me Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, për ndërtimin e ndërtesës së përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor.

Me datë 23 qershor 2022 u mbajt mbledhja e III-të (3) e legjislaturës së tretë e Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u nxorr Vendimi për miratimin e amandamenteve për plotësim/ndryshimin e akteve normative të OMK-së si në vijim:

- Rregullorja e Punës të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së;
- Rregullorja e Komisionit për Edukim të Vazhdueshëm Profesional;
- Rregullorja së Komisionit të Antarësisë, Licencimit dhe Rilicencimit;
- Rregullorja për përcaktimin e shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes Etike;
- Rregullorja për Menaxhimin e Financave të OMK-së;
- Rregullorja për Procedurat e Prokurimit në OMK-së;

Gjithashtu u marrën vendimet si në vijim:

- Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit për paga dhe mëditje;

Me datë 27 dhjetor 2022 u mbajt mbledhja e IV (4) e legjislaturës së tretë e Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u nxorr Vendimi për miratimin e amandamenteve për plotësim/ndryshimin e akteve normative të OMK-së si në vijim:

- Kodit Zgjedhor të OMK-së;
- Rregullorja e Komisionit për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim;
- Rregullorja e Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke;
- Rregullorja e Komisionit për Dhënie dhe Dekorativë;
- Rregullorja e Revistës Mjeku të OMK-së;
- Rregullorja e Komisionit për Çështje Etike;

Poashtu u mbajt procesi zgjedhor për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së;

Ndërsa dy pikat si më poshtë pas shqyrtimit dhe diskutimit u vendos që të shqyrtohen përsëri në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të OMK-së.

- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës së Komisionit për Edukim të Vazhdueshëm Profesional; dhe
- Draft-Projekt Buxheti i OMK-së për vitin 2023.

## ***2. Këshilli Drejtues***

Gjatë vitit 2022, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur 13 takime, si dhe në 5 raste kanë votuar në mënyrë elektronike përmes e-mailit, ku janë pranuar 71 lëndë dhe janë marrë 61 vendime sipas kërkesave/ankesave të pranuar.

Sfidat apo vështirësitë të cilat e kanë përcjellë Këshillin Drejtues të OMK-së gjatë vitit 2022 janë:

- Ligji për paga-vendimi i gjykatës kushtetuese - Avokimi i OMK-së
- Bartja e kompetencës për edukimin specialistik
- Sigurimi i parcellës për ndërtesën e OPSH-ve - refuzimi nga SHSKUK për ndarjen e një parcele brenda QKUK-së
- Zbatimi i Ligjit për Shëndetësi dhe Ligjit për OPSH-të

### 3. Anëtarësimi

Gjatë vitit 2022 janë anëtarësuar 455 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve ka arritur në 5002 mjekë, ku 3785 mjekë janë të punësuar në sektorin publik, 715 mjekë në sektorin privat, 365 mjekë të papunë, 104 mjekë pensionist dhe 33 mjekë janë anëtarë por jetojnë dhe e ushtrojnë profesionin jashtë Kosovës.

Gjatë vitit 2022 për arsye të ndryshme, janë ç'anëtarësuar 200 mjekë.




Tabela 1 Anëtarësime deri 31 dhjetor 2022




Tabela 2. Anëtarët e ndarë sipas moshës

Bazuar në tabelën më lartë shihet se mosha mesatare e mjekëve anëtar është 47 vjeç, anëtari më i ri është 24 vjeç, kurse anëtari më i vjetër është 87 vjeç.

#### **4. Mbikëqyrja etiko-profesionale**



Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2022	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2022	Sanksionet e shqiptuara për vitin 2022	Sanksionet e ekzekutuara për vitin 2022	Lëndët në shqyrtim
<b>Prokurori i Odës</b>	46	41*	///	///	15
<b>Këshilli Etik</b>	31	36*	Rekomandime kolegjale – 11 Qortime publike – 8 Gjoha: 1	Rekomandime kolegjale 11 Qortime publike - 8 Gjoha 1	6
<b>Gjyqi i Nderit</b>	4	4	///	///	0
<b>Certifikatat e të kalurës etike</b>	211	///	///	///	///

\* Në Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2022 janë të përfshira edhe Vendimet e nxjerra për lëndët e bartura nga viti 2021.

Në shqyrtim të drejtpërdrejtë, janë mbajtur tri seanca të shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë).

Gjatë vitit 2022, janë lëshuar 211 certifikata për të kaluarën etike. Doktor të Mjekësisë janë 116 mjekë, Specializant janë 81 kurse Specialist janë 14 mjekë që kanë kërkuar t'ju lëshohet certifikata për të kaluarën etike. Mosha mesatare e mjekëve që janë paisur me certifikata është 31 vjet. Nga ta 109 janë meshkuj dhe 102 janë femra.





Gjatë vitit 2022 nga numri total i mjekëve që kanë kërkuar certifikata për të kaluarën etike, 65.24% apo 137 janë mjekë që kanë diplomuar katër vitet e fundit.

### **5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional**


Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë vitit 2022, ka akredituar 165 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, trembëdhjetë shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve, pesë nga kërkesat janë refuzuar për përkrahje financiare kurse tetë kërkesa janë aprovuar nga Komisioni.





## 6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Ri-licencim profesional gjatë vitit 2022, ka lëshuar 2069 licenca me kategoritë si në grafikun e më poshtëm:



## 7. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është i bllokuar në tërsi, pasi që në draft e UA-së për shkollim specialistik, drafti i shtator-tetor 2022, janë shkelë të gjitha

Dispozitat ligjore të parapara me ligjin e Shëndetësisë dhe ate të OPSH-ve. Ky dokument është kontestuar zyrtarisht nga OMK,OSK dhe OFK

## 8. Këshilli Mbikqyrës

Në periudhën kohore janar–dhjetor 2022, Këshilli Mbikqyrës i OMK-së ka mbajtur katërmbëdhjetë (14) takime, ku është bërë shqyrtimi i vendimeve të Këshillit Drejtues dhe të organeve të tjera të OMK-së, ligjshmëria e tyre konform akteve juridike të OMK-së dhe ligjeve në fuqi.

## 9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në vitin 2022, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar 72 kërkesa për leje hulumtimi ka shqyrtuar 67 prej tyre.

56 kërkesat e parashtruara nga palët janë aprovuar, dhe aplikuesëve u janë lëshuar lejet për hulumtim, pesë (5) kërkesa nuk janë aprovuar për shkak të mospërbushjes së

kritereve, katër (4) kërkesa komisioni i ka kthyer për plotësim të lëndës, ndërsa dy (2) kërkesa janë dërguar në UP për shqyrtim. Pesë (5) kërkesa janë në shqyrtim pasi që janë parashtruar pranë administratës së OMK-së me datë 29 dhe 30 dhjetor 2022.

### **10. Komisioni për Edukim Specialistik**

Në periudhën kohore janar - dhjetor 2022, Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur tetë (8) takim. Përgjatë këtyre takimeve komisioni ka punuar rreth plotësim-ndryshimit të draft rregullorës për Edukim Specialistik.

### **11. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së**

Në vitin 2022, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar katërbëdhjetë (14) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë dymbëdhjetë (12) vendime për aprovimin e kërkesave të parashtruara nga palët, ndërsa dy (2) vendime për refuzim të kërkesave.

## **12. Raporti Financiar**

### **12.1 Gjendja financiare – 31 dhjetor 2022**

<b>1.0 Të hyrat:</b>					
1.1 Të hyrat e bartura nga 2021	€	611,305			
<b>Total të hyrat e bartura nga 2021</b>					<b>€611,305</b>
<b>1.1 Të hyrat</b>	<b>Realizimi: TM1</b>	<b>Realizimi: TM2</b>	<b>Realizimi: TM3</b>	<b>Realizimi: TM4</b>	<b>TOTAL</b>
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:					
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 269,390	€ 86,910	€ 15,411	€ 3,679	€ 375,390
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 3,050	€ 5,060	€ 1,500	€ 700	€ 10,310
1.1.4 Licencimi	€ 34,730	€ 27,280	€ 18,560	€ 19,260	€ 99,830
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€ 10,821	€ 19,932	€ 22,873	€ 23,622	€ 77,249
1.1.6 Donacione për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve	€ 1,000	N/A	N/A	N/A	€ 1,000
1.1.7 Projekti i LuxDEV	€ 84,000	N/A	N/A	€ 120,000	€ 204,000
<b>Të hyrat deri me 31.12.2022</b>	<b>€ 402,991</b>	<b>€ 139,182</b>	<b>€ 58,344</b>	<b>€ 167,261</b>	<b>€ 767,778</b>
<b>Të hyrat e bartura nga 2021</b>					<b>€ 611,305</b>
<b>TOTAL TË HYRAT</b>					<b>€ 1,379,083</b>

<b>2.0 SHPENZIMET</b>	<b>Shpenzimet: TM1</b>	<b>Shpenzimet: TM2</b>	<b>Shpenzimet: TM3</b>	<b>Shpenzimet: TM4</b>	<b>TOTAL</b>
2.1 Paga, medetje dhe kontributet pensionale	€ 69,644	€ 60,641	€ 47,017	€ 68,658	€ 245,961
2.2 Material shpenzues	€ 830	€ 1,313	€ 1,078	€ 1,925	€ 5,147
2.3 Reprerentacioni	€ 585	€ 557	€ 574	€ 909	€ 2,625
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 2,920	€ 19,116	€ 57,639	€ 100,315	€ 179,990
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 6,700	€ 12,464	€ 11,756	€ 29,355	€ 60,275
2.6 Shpenzimet e asetëve		€ 600	€ 6,580	€ 1,900	€ 9,080
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 1,620	€ 3,266	€ 4,780	€ 3,390	€ 13,056
2.8 Xhironlogaria për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve	€ 53,856	N/A	N/A	N/A	€ 53,856
<b>TOTAL SHPENZIMET 31.12.2022</b>	<b>€ 136,155</b>	<b>€ 97,958</b>	<b>€ 129,424</b>	<b>€ 206,452</b>	<b>€ 569,989</b>
<b>Neto të hyrat për TM 2022</b>	<b>€ 266,836</b>	<b>€ 41,224</b>	<b>€ (71,080)</b>	<b>€ (39,191)</b>	<b>€ 197,789</b>
<b>TOTAL BILANCI</b>					<b>€ 809,094</b>

1.1.5\* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimili, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera .

2.5\* Faksimili, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, i, Shpenzimet e tjera operative.

2.8\* Projekti i përbashkët i Odave të Profesionistëve Shëndetësor, për ndërtimin e obeliskut “Për Jetën” kushtuar veprës dhe sakrificës së profesionistëve shëndetësor ndër dekada, ka filluar në vitin 2021 dhe ka vazhduar edhe në vitin 2022, kur edhe është bërë inaugurimi. Mjetet e përbashkëta për këtë projekt janë menaxhuar nga OMK. Rrjedhimisht, edhe janë paraqitur në pasqyrat financiare të Odës.

## 12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2022 ka përkrahur financiarisht 16 aktivitete grupore për Edukim të Vazhdueshëm Profesional. Vlera totale e aktiviteteve të përkrahura është 180,705.50 €.

- Shoqata e Nefrologëve të Kosovës, Kongresi “Dita botërore e veshkës”, me vlerë 1,500.00 €
- Asociacioni i Psikiatërve të Kosovës, “Programi vjetor i EVM-së për profesionistët e Shëndetit Mendor Maj-Qershor 2022” me vlerë 2,240.00 €
- Shoqata e Anesteziologëve dhe Intensivistëve të Kosovës, “Seminari Kombëtar”, me vlerë 210 €.
- Kolegji i Kirurgëve të Kosovës, Java e Puntorive “Intervenimet Laparoskopike-Endoskopike në 4 lëmi Kirurgjike dhe Ultratingulli” me vlerë 3,067.00 €.
- Shoqata e Kirurgëve Pediatrik të Kosovës, Konferenca e 14-të e EUPSA-s – Kirurgjia minimale invazive të fëmijëve. me vlerë 8,700.00€
- Kongresi i Tretë të Mjekësisë, “Pandemia COVID-19, Sfidat dhe Përvojat” në vlerë 38,713.00 €

- Kongresi i Katërt të Mjekësisë, “Diabeti Melit, Qasja interdisiplinare” në vlerë 44,635.50 €
- Bashkëorganizimi me Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës i Kongresit të Dytë Klinik me vlerë 32,000.00 €.
- Shoqata e Kardiologëve Kosovës me vlerë prej 2,800.00 €
- Shoqata e Neonatologëve të Kosovës me vlerë prej 2,000.00€.
- Trajnimet profesionale për mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit me tema Kursi për Dopplerin e enëve të gjakut, Kursi për Echo transezofageale, Kursi për Ultratingullin e artikulacionit coxofemoral tek neonatët, Kursi për EEG dhe Ultratingulli i trurit (tek fëmijët), Kursi për Ultrasonografinë Abdominale, Kursi për Punksionin e Gjëndrës Tiroide. Vlera për organizimin e trajnimeve është 44,840.00 €

### 12.3 Prokurimi

Gjatë vitit 2022 u zhvilluan 8 procedura të hapura të prokurimit, 4 procedura të negociuara të prokurimit dhe 5 procedura të prokurimit me vlera të vogla:

Procedura të hapura të prokurimit të zhvilluara me sukses për:

- Furnizimin me faksimil për anëtarët e OMK-së
- Furnizimin me material shpenzues për zyret e OMK-së
- Furnizim me inventar për nevojat e zyrës të OMK-së
- Auditimin FunkSIONAL dhe Financiar të OMK-së

Disa nga procedurat e lartëshënuara janë anuluar për arsye të mungesës së ofertave të pranuar, ndërsa pas përsëritjes së procedurave të prokurimit të njëjtat janë zhvilluar me sukses dhe janë nënshkruar kontratat me Operatorët Ekonomik. Procedura e Prokurimit për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së për arsye të mungesës së ofertave është anuluar dhe e njëjta do të përsëritet gjatë muajit janar 2023.

Procedura të prokurimit me vlera të vogla të zhvilluara me sukses për:

- Përzgjedhjen e lokacionit për organizimin dhe mbajtjen e mbledhjes së kuvendit të OMK-së legjislatura e II
- Ndërtimin e stendave për panairin e Kongresit
- Krijimin e aplikacionit për regjistrimin dhe verifikimin e pjesëmarrësve në Kongres
- Përzgjedhjen e lokacionit për organizimin e trajnimit për procedurat e përgjithshme administrative

- Përzgjedhja e lokacionit për organizimin e ceremonisë për përfundimin e fazës së parë të trajnimeve profesionale

Procedura të negociuara të prokurimit të zhvilluara me sukses për:

- Përzgjedhjen e vendit të mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të OMK-së
- Përzgjedhjen e vendit të mbajtjes së Kongresit
- Përzgjedhjen e hapsirës për mbajtjen e eventeve të OMK-së
- Furnizimin e OMK-së me material shpenzues për nevojat e organizimit të Kongresit

## **12.4 Botimi i Revistës Mjeku**

Me datë 30 mars 2021, në ditën ndërkombëtare të mjekëve, OMK bëri botimin e Revista Mjeku. Kjo revistë botohet për herë të parë në Kosovë, e cila trajton aktualitete të ndryshme nga mjekësia kosovare dhe më gjerë.

Revista “Mjeku” botohet katër herë në vit nga Oda e Mjekëve të Kosovës. Qëllimi i botimit të revistës është për të informuar mjekët dhe profesionistët tjerë shëndetësor rreth zhvillimeve, risive në medikamente dhe praktikimi i tyre në dobi të pacientit, botimi i hulumtimeve shkencore, artikujve të ndryshëm për informimin dhe edukimin shëndetësor të qytetarëve për sëmundje të ndryshme, gjithashtu informimi i qytetarëve për shërbimet shëndetësore që u ofrohen në Spitale dhe Qendra familjare në Kosovë. Revista mund edhe të përmbajë reklama shtesë të cilat do ndihmonin në rritje të cilësisë së botimit.

Publikimet në revistë janë të karakterit informues, analizues, lajmërues dhe të bazuara në fakte.

Gjatë vitit 2022 janë publikuar 4 numra të Revista Mjeku me temë Sëmundjet Kardiovaskulare, Sëmundjet Neurologjike, Shëndeti Mendor dhe Diabeti.

Revista është e publikuar edhe online në faqën e Odës së Mjekëve të Kosovës (linku: [REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë.

## **12.5 Obelisk kushtuar punëtorëve shëndetësor**

Me datë 16 shkurt në hyrjen e QKUK-së u bë inagurimi i monumentit përkujtimor-Obelisk.

Ky monument u realizua nga Odat e Profesionistëve Shëndetësor me përkrahjen edhe të donatorëve të ndryshëm.

Gjithashtu me datë 16 shkurt Odat e Profesionistëve Shëndetësor morrën vendim që kjo datë të shpallet ditë Përkujtimore e profesionistëve shëndetësor të Republikës së Kosovës.

## **12.6 Tryeza e rrumbullakët - “Gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë – Kemi apo nuk kemi sistem shëndetësor funksional? Kahja e reformës së nevojshme”**

Me datë 24 shkurt 2022 u mbajt Tryeza e rrumbullakët me temën “Gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë – Kemi apo nuk kemi sistem shëndetësor funksional? Kahja e reformës së nevojshme”.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin të shumica e akterëve të sistemit shëndetësor të Kosovës si dhe ekspert të jashtëm.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte prezantimi dhe diskutimi i çështjeve problematike të sistemit tonë shëndetësor.

## **12.7 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim**

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i Luxembourg Development KSV/017, kanë nënshkruar marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngrisin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në aspektin profesional.

Në këtë drejtim Oda e Mjekëve në bashkpunim me Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, kanë identifikuar nevojat për trajnime dhe si rezultat ka filluar procesin e rekrutimit të trajnerave të kualifikuar për të implementuar trajnimet e nevojshme.

Rrjedhimisht, faza e parë e trajnimeve me fokus në fushën e Radiosagnostikës u organizua gjatë muajit Tetor dhe Nëntor, ku u mbuluan trajnimet në fushat si në vijim:

- Kursi për Dopplerin e enëve të gjakut
- Kursi për Echo transezofageale
- Kursi Ultratingulli i trurit dhe EEG (tek fëmijët)
- Kursi për funksionin e gjëndrës tiroide
- Kursi për Ultrasonografinë abdominale
- Ultratingulli i artikulacionit coxofemoral tek neonatët

Në bashkëpunim me menaxhmentin e Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit u organizua pjesa teorike dhe praktike e këtyre trajnimeve. Ishin 10 trajner ekspert të fushave përkatëse të angazhar për realizimin e këtyre trajnimeve. Pjesëmarrës që përfituan nga këto trajnime ishin 28 mjekë nga Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit dhe Prizrenit. Trajnimet që kanë zgjatur nga 5 deri në 15 ditë ju kanë mundësuar mjekëve pjesëmarrës të realizojnë vizita me pacientë, me qëllimin për ti praktikuar mësimet e marra gjatë ligjëratave, ku secilit pjesëmarrës ju ofrua mundësia të punojë me pajisje ultrasonografike, për ta fituar pavarësinë në punë.

Ndërsa për pjesën tjetër të trajnimeve, për shkak të mungesës së aplikimeve, është vendosur të rishpallet thirrja për trajner dhe në të njëjtën kohë të hulumtohet për trajner/ekspertët e mundshëm edhe jashtë Kosovës. Këto trajnime planifikohen të fillojnë në fillim të tremujorit të parë 2023.

Projekti ka alokuar një vlerë prej 120,000.00€ për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të odës, si dhe mbështetjen për organizimin të trajnimeve profesionale-profilizimeve për një numër të përzgjedhur të mjekëve nga spitalet e përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Projekti i Luxembourg Development KSV/017 ka alokuar vlerën prej 120,000.00€ për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të odës, si dhe mbështetjen për organizimin të trajnimeve profesionale-profilizimeve për një numër të përzgjedhur të mjekëve nga spitalet e përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit. Në fazën e parë të marrëveshjes nga projekti Lux Dev janë bartur 84,000.00€.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur raporti financiar nga marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim

<b>Të hyrat:</b>	<b>84,000.00</b>
------------------	------------------

Shpenzimet	Njësia	pax	Numri i njësive	Vlera për njësi (në euro)	Kostoja totale (në euro)
<b>1. Trajnime</b>					
<b>Ngritja e kapaciteteve të stafit</b>					
1.1.1. Vizitë studimore në Kroaci	person	20	1	952.36	19047.28
1.1.2. Trajnime profesionale për stafin profesional të OMK-së	person	13	1	219.32	2851.24
Reklamim i thirrjes publike	njësi	1	1	95	95
<b>Total shpenzimet të trajnimeve per ngritja e kapaciteteve të stafit</b>					<b>21,993.52</b>
<b>Ngritja e kapaciteteve të mjekëve</b>					
1.2.1 Trajnimet Profesionale në Kosovë					
Ekspertë Kombëtarë në ditë gjithëpërfshirëse (Kompania e kontraktuar)					
1.2.1.1. Trajnimi me Doppler e enëve të gjakut	person	5	1	1,180.00	5,900.00

1.2.1.2. Trajnimi me ultratinguj abdominal	person	5	1	1,770.00	8,850.00
1.2.1.3. Trajnimi për funksionin e gjëndrës tiroide	person	4	1	1,770.00	7,080.00
1.2.1.4. Trajnim ekokardiografie transesophageale	person	4	1	1,770.00	7,080.00
1.2.1.5. Trajnimi me ultratinguj i artikulacionit koksofemoral	person	5	1	1,416.00	7,080.00
1.2.1.6. Neurosonografia dhe EEG - aplikimi në trajnimin e fëmijëve	person	5	1	1,770.00	8,850.00
Ceremonia e përfundimit të fazës së parë të trajnimeve profesionale	njësi	1	1	1,600.00	1,600.00
Reklamim i thirrjes publike	njësi	2	1	85	170
<b>Total shpenzimet të trajnimeve Profesionale në Kosovë</b>					<b>46,610.00</b>
<b>Total shpenzimet të trajnimeve per ngritja e kapaciteteve të mjekëve</b>					<b>46,610.00</b>
<b>Shpenzimet totale për trajnime</b>					<b>68,603.52</b>
<b>2. Kostot e udhëtimit</b>					
Biletat e takimit Zeva (Simpoziumi i Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore)	person	2	1	199.28	398.56
Akomodimi takimit Zeva (Simpoziumi i Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore)	person	2	1	540.82	1,081.64
Mëditje takimi i Zevës (Simpoziumi i Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore)	person	2	1	414.8	829.6
Sigurim shëndetsor	person	1	1	72	72
Biletat e takimit të CPME (Lobim dhe rrjetëzim për takimin e Zevës)	person	1	1	338.89	338.89
Akomodimi i takimit të CPME (Lobim dhe rrjetëzim për takimin e Zevës)	person	1	1	258.8	258.8
Mëditje takimi i CPME (Lobim dhe rrjetëzim për takimin e Zevës)	person	1	1	20.51	20.51
<b>Total shpenzimet të udhëtimit</b>					<b>3,000.00</b>
<b>3. Pajisjet, furnizimet dhe ndërtesat</b>					
Kompjuter	njësi		4	0	0
Pajisje tjera të Teknologjisë Informative	njësi		1	0	0
Inventar	njësi		19	355.79	6,760.00
<b>Shpenzime të tjera (komision bankar)</b>	njësi		1	205.8	<b>205.8</b>
<b>Total shpenzimet për pajisje furnizimeve dhe ndërtesave</b>					<b>6,965.80</b>
<b>TOTAL SHPENZIMET 31.12.2022</b>					<b>78,569.32</b>
<b>TOTAL BILANCI</b>					<b>5,430.68</b>

## 12.8 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së

Në kuadër të marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve, është e përfshirë edhe ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së. Në fazën e parë janë organizuar trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, si dhe ato specifike si kursi për Procedurat e përgjithshme administrative.

Gjithashtu gjatë muajit Tetor dhe Nëntor, në kuadër të bashkëpunimit mes Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Odës së Mjekëve të Kroacisë, stafi profesional si dhe përfaqesues të organeve të OMK-së kanë realizuar dy vizita studimore në Zagreb.



Qëllimi i këtyre vizitave është ngritja e kapaciteteve të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe forcimi i rolit të këshilleve/komisioneve brenda odës. Gjatë këtyre vizitave studimore u trajtuan temat për pjesën administrative/operative dhe ligjore (proceset që mbështesin Licencimin, anëtarësimin, Mbikëqyrja Etiko-Profesionale, Edukimi i Vazhdueshëm Profesional, Revista e odës, Sistemi ligjor/Rregulloret dhe sfidat me të cilat përballet Oda me organet gjyqësore shtetërore. Gjithashtu u ndanë përvojat mes dy Odave, përkatësisht në fushën juridike.

## 12.9 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2022	Vendimet sipas urdhëresave së pranuar për vitin 2022	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për vitin 2022	Lëndët e bartura nga periodat paraprake
<b>Kryetari i Odës</b>	6	6	3	3	0

## 12.10 Marrëdhënie ndërkombëtare

Përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morrën pjesë në takimin e përvitshëm të Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore, simpoziumi i 29-të i ZEVA-së.

Këtë vit diskutimet u përqëndruan në temat rreth karakteristikave kryesore të procedurave disiplinore në Odë, Apeli i ndërgjegjes dhe Kodi Etik Ndërkombëtar të Mjekësisë si dhe Sfidat aktuale në sistemin spitalor.

## Takimi vjetor i Shoqatës Botërore të Mjekësisë si dhe 75 vjetori Odës së Mjekëve të Gjermanisë

Këto dy aktivitete të rëndësishme u mbajtën në Berlin njëkohësisht.

Çështjet e diskutuara gjatë mbledhjes fokusuan në rishikimet e Kodit Ndërkombëtar të Etikës Mjekësore, të cilat janë hartuar pas muajsh diskutimesh. Tema të diskutuara kanë përfshirë edhe diskriminimin e kujdesit shëndetësor ndaj të moshuarve, racizmin në mjekësi dhe rritjen e aktiviteteve të kujdesit shëndetësor dixhital dhe telemjekësi si dhe mënyra më e mirë për alokimin e drejtë burimeve shëndetësore (në emergjencat e shëndetit publik).

### **Mbledhja e Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME).**

Përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morrën pjesë në punimet e takimit të radhës së Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME).

Nikoqiri i këtij takimi ishte Oda e Mjekëve të Çekisë. Tema diskutimi gjatë mbledhjes ishin:

- Investimi në të ardhmen e kujdesit shëndetësor
- Shëndetësia digjitale
- Shëndeti publik dhe preventiva e sëmundjeve ngjitëse
- Sistemi shëndetësor dhe praktika profesionale.

Gjatë këtij eventit u zhvilluan takime në mes të përfaqësuesve të OMK-së, odave dhe shoqatave të mjekëve Evropiane lidhur me bashkëpunimin e mundshëm në fushat e interesit që ju takojnë.

Komiteti i Përhershëm Evropian i Mjekëve (CPME) është institucioni ndërkombëtar me ndikimin në politikbërje në nivel evropian dhe ka një rëndësi të madhe në rregullimin e sektorit shëndetësor në nivel te vendeve të Bashkimit Evropian.

Oda e Mjekëve të Kosovës është anëtare vëzhguese në këtë organizatë që nga viti 2018, ku deri më tani ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara.

### ***13. Plani i veprimit për 2023***

#### **Projektet/Planet 2023**

- Fillimi i zbatimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë” dhe OPSH-të.
- Fillimi i zbatimit të sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 2.5 vite.
- Organizimi i Kongresit të V multidisiplinar
- Organizimi i ceremonisë së 10 vjetorit të formimit të OMK-së
- Fillimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit
- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim KSV/017 - 21 2749, faza e dytë për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve
- Hulimtim për vlerësimin e ngarkesës së sëmundjes kronike dhe sindrominit burnout (shpenzimi profesional i mjekëve)